



# STATUT

## I

# *LËVIZJES BESA*

---

*Dhjetor, 2014*  
*Shkup*

Përmbajtja:

<b>1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b> .....	4
1.1. Identiteti.....	4
1.2. Emri i Lëvizjes.....	4
<b>2. EMBLEMA DHE FLAMURI</b> .....	4
<b>3. VULA DHE SELIA</b> .....	5
3.1. Përkufizimi juridik.....	5
<b>4. QËLLIMET DHE VIZIONI</b> .....	5
4.1. Hierarkia e akteve.....	7
<b>5. ANËTARËSIMI</b> .....	7
5.1. Procedura e anëtarësimit.....	7
5.2. Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve.....	8
5.3. Humbja e statusit të anëtarit.....	8
<b>6. ORGANIZIMI I LËVIZJES BESA</b> .....	9
<b>7. ORGANET LOKALE</b> .....	9
7.1. Këshilli vendor.....	9
7.2. Kuvendi i Këshillit vendor.....	10
7.3. Kryesia e Këshillit vendor.....	10
7.4. Kryetari i Këshillit vendor.....	11
7.5. Këshilli mbikëqyrës i Këshillit vendor.....	11
7.6. Këshilli komunal.....	11
7.7. Kuvendi i Këshillit komunal.....	12
7.8. Mbledhjet e Kuvendit të Këshillit komunal.....	12
7.9. Të drejtat dhe detyrimet e Kuvendit të Këshillit komunal.....	13
7.10. Kryesia e Këshillit komunal.....	13
7.11. Kryetari i Këshillit komunal.....	14
7.12. Sekretari i Këshillit komunal.....	15

7.13.	Këshilli Mbikëqyrës i Këshillit komunal.....	15
<b>8.</b>	<b>ORGANET QENDRORE TË LËVIZJES BESA.....</b>	<b>16</b>
8.1.	KONGRESI.....	16
8.1.1.	Përbërja e Kongresit.....	16
8.1.2.	Kompetencat e Kongresit.....	17
8.1.3.	Kongresi i jashtëzakonshëm.....	17
<b>9.</b>	<b>KËSHILLI QENDROR.....</b>	<b>17</b>
9.1.	Përbërja e Këshillit Qendror.....	18
9.2.	Mbledhjet dhe vendimmarrja e Këshillit Qendror.....	18
9.3.	Kompetencat e Këshillit Qendror.....	18
<b>10.</b>	<b>KRYETARI I LËVIZJES BESA.....</b>	<b>19</b>
10.1.	Kompetencat e Kryetarit.....	20
10.2.	Nënkryetarët e Lëvizjes BESA.....	20
<b>11.</b>	<b>KRYEASIA QENDRORE.....</b>	<b>21</b>
11.1.	Kompetencat e Kryesisë Qendrore.....	21
<b>12.</b>	<b>KËSHILLI MBIKËQYRËS QENDROR I LËVIZJES BESA.....</b>	<b>22</b>
<b>13.</b>	<b>SEKRETARI GJENERAL.....</b>	<b>22</b>
13.1.	Kompetencat e Sekretarit Gjeneral.....	23
<b>14.</b>	<b>FINANCIMI.....</b>	<b>23</b>
<b>15.</b>	<b>FORUMI I GRUAS DHE FORUMI RINOR.....</b>	<b>24</b>
<b>16.</b>	<b>GRUPI PARLAMENTAR DHE PËRFAQËSUESIT ZGJEDHUR.....</b>	<b>24</b>
<b>17.</b>	<b>ORGANET TJERA – Sekretariatet.....</b>	<b>25</b>
17.1.	Sekretariati i Departamenteve.....	25
17.2.	Sekretariati i politikave strategjike.....	26
17.3.	Sekretariati burimeve njerëzore dhe lobimit.....	27
17.4.	Sekretariati organizativ.....	27
17.5.	Sekretariati i marrëdhënieve me publikun.....	27
<b>18.</b>	<b>QENDRA HULUMTUESE-ANALITIKE.....</b>	<b>28</b>
<b>19.</b>	<b>DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE.....</b>	<b>29</b>

Në bazë të nenit 14, 16 dhe 17 të Ligjit për partitë politike ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08 dhe 23/13) si dhe (Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.57/07 dhe 60/07), Kuvendi Themelues i Lëvizjes BESA, në mbledhjen e saj të mbajtur më datë 22.11.2014 në Shkup, solli këtë:

# **STATUT TË LËVIZJES BESA**

## **1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1**

Me këtë Statut rregullohet qëllimi, mënyra organizative e organeve, emri, emblema, flamuri, vula, selia, emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve, mënyra e përfaqësimit, mënyra e financimit, shuarja, pronësia, si dhe dispozita të tjera me rëndësi të Lëvizjes BESA.

#### **1.1. Identiteti**

### **Neni 2**

Lëvizja BESA është organizatë politike që në qendër të vëmendjes së saj para së gjithash e ka qytetarin shqiptar, pa e përjashtuar asnjë qytetar tjetër të Republikës së Maqedonisë.

Lëvizja BESA si subjekt politik përshkruhet me tre A:

- AUTENTIKE sepse buron nga nevojat reale të shqiptarëve në Maqedoni;
- AUTOKTONE sepse është krijuar nga kapacitetet vendore shqiptare në Maqedoni; dhe
- AUTONOME sepse është e hapur për bashkëpunim me të gjithë, ajo është lëvizje e pavarur, subjekt në vete dhe e pavarur nga çdo subjekt i brendshëm apo i jashtëm.

#### **1.2. Emri i Lëvizjes**

### **Neni 3**

Emri i plotë i subjektit është: "Lëvizja BESA".

Shkurtesa e Lëvizjes është: "BESA".

## **2. EMBLEMA DHE FLAMURI**

### **Neni 4**

Lëvizja BESA ka emblemën, flamurin, vulën dhe selinë e saj.

Emblema e Lëvizjes BESA paraqet figurë identifikimi formal apo zyrtar të Lëvizjes BESA.

Emblema në anën e sipërme dhe të poshtme paraqet formë mburoje, në mes ka shkronjën “B” me ngjyrë të bardhë, ku brendia është e kuqe dhe harku ndër shkronjën “B” është me ngjyrë të zezë. Në Anën e djathtë shkruan “Lëvizja BESA”.

#### **Neni 5**

Flamuri është në ngjyrë të bardhë ku në mes ka emblemën e Lëvizjes BESA.

### **3. VULA DHE SELIA**

#### **Neni 6**

Lëvizja BESA ka vulën dhe faksimilen e saj.

Vula e Lëvizjes BESA është në formë të rrumbullakët, ku Vula e ka formën e rrethit, e cila përmban tekstin në gjuhën shqipe dhe maqedonase: Lëvizja BESA – Shkup \* Движење БЕСА – Скопје. Në mes të vulës është emblema e Lëvizjes.

Faksimilja e ka formën e katërkëndëshit me tekstin në gjuhën shqipe dhe maqedonase: Lëvizja BESA – Shkup \* Движење БЕСА – Скопје, me vendin e rezervuar për emrin e protokollit dhe datën. Në anën e majtë të faksimile është emblema e Lëvizjes BESA.

Vula përdoret vetëm në emër të Organeve Qendrore të Lëvizjes BESA dhe administratës ekzekutive të Selisë Qendrore.

Këshillat Komunal të Lëvizjes BESA kanë vulat dhe faksimilen e tyre duke shtuar emrin përkatës të këshillit komunal.

Forma e përmbajtjes dhe mënyra e përdorimit do të rregullohet me Rregullore të veçantë që do ta nxjerrë Këshilli Qendror i Lëvizjes BESA.

#### **Neni 7**

Selia e Lëvizjes BESA është në rr. \_\_\_\_\_ nr. \_\_\_\_\_, Shkup.

#### **3.1. Përkufizimi juridik**

#### **Neni 8**

Lëvizja BESA ka cilësinë e personit juridik.

### **4. QËLLIMET DHE VIZIONI**

#### **Neni 9**

Lëvizja BESA ka për qëllim konkurrimin politik përmes zgjedhjeve të përgjithshme, në respekt të vlerave të lirisë, barazisë e drejtësisë në një garë politike. Ajo synon të promovojë në interes të gjithë qytetarëve e posaçërisht shqiptarëve të Maqedonisë, lirinë e mendimit dhe dinjitetin e individit, të drejtat dhe detyrat themelore të tyre, zhvillimin lirë e barazinë në mundësi, tregun e lirë e konkurrues si instrument për zhvillimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm të vendit, shtetin e së drejtës, sigurinë e individit dhe të pronës, përgjegjësinë individuale e fuqizimin e familjes, drejtësinë shoqërore e dialogun social,

ruajtjen e natyrës dhe të ambientit, autoritetin e shtetit dhe vetëqeverisjen e lirë të komuniteteve lokale.

BESA angazhohet për integrimin e Maqedonisë në organizmat evropiane e euroatlantike si dhe për një rrezatim pozitiv të imazhit të vendit kudo në botë.

Lëvizjes BESA bashkon rreth saj të gjithë qytetarët që u përmbahen këtyre aspiratave dhe objektivave.

Lëvizja BESA garanton shprehjen e lirë të sensibiliteteve politike që e përbëjnë atë. Ajo bazohet në respektin e paritetit gjinor në jetën e Lëvizjes dhe në pjesëmarrjet zgjedhore e ekzekutive.

Lëvizja BESA synon:

- Që shtetin e Maqedonisë ta kthejë në shtet simetrik, ku shoqëria është kompatible në raport me shtetin.
- të ndërtojë sistem gjyqësor të pavarur dhe profesional;
- të ndërtojë një shtet demokratik;
- Avancimin e të drejtave njerëzore të njohura ndërkombëtarisht;
- të ofrojë zgjidhje të gjitha tensioneve dhe urrejtjeve ndëretnike dhe religjioze duke zhdukur të gjitha format e diskriminimeve në baza nacionale, religjioze, racore e gjinore të qytetarëve të R. së Maqedonisë;
- të ndërtojë shtetin ligjor me raporte të ndara qartë të pushteteve, garantimit të jetës, lirive dhe të drejtave të sanksionuara me ligj të qytetarëve;
- të nxisë dhe zhvillojë ekonominë e tregut të lirë;
- të garantojë të drejtën e pronës private, paprekshmërinë e saj dhe të drejtën e pronarëve për ta disponuar atë lirisht, trashëguar apo dëmshpërblyer me vlerë të plotë tregu;
- avancimin e pozitës së gruas si e drejtë universale dhe e patjetërsueshme;
- të zhdukë privilegjet dhe pabarazitë e të gjitha llojeve që bazën nuk e kanë në ligj;
- të integrojë Maqedoninë si anëtare dinjitoze në institucionet euroatlantike e në familjen e kombeve të përparuara evropiane;
- të garantojë sigurinë e të gjithë qytetarëve dhe të bashkëpunojë me institucionet evropiane dhe të tjera organizma ndërkombëtarë për të siguruar paqen, lirinë, demokracinë, garancinë ekonomike dhe mbrojtjen e mjedisit për të gjithë rajonin dhe më gjerë;
- respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave të garantuara me Kushtetutë;

- të krijojë një sistem të sigurisë shtetërore të qëndrueshëm, profesional dhe efikas, duke bashkëpunuar me Bashkimin Evropian, NATO-n, vendet fqinje dhe me ato te rajonit, për të mundësuar një ambient sigurie të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë;
- të mbrojë interesat dhe të drejtat njerëzore të të gjithë qytetarëve duke respektuar aktet e marrëveshjet ndërkombëtare dhe duke kërkuar standardet e pranuar botërisht për të gjithë; etj.

Politika e Lëvizjes BESA përcaktohet dhe pasqyrohet në programin e saj si dhe në dokumentet e tjera që miratohen në përputhje me Statutin nga organet e saj qendrore.

#### 4.1. Hierarkia e akteve

##### **Neni 10**

Akti më i lartë brenda Lëvizjes BESA është Statuti i saj. Të gjitha aktet tjera duhet të jenë në përputhje me Statutin.

Statuti i Lëvizjes BESA është në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjet e Republikës së Maqedonisë.

Përveç Statutit, Lëvizja BESA mund të nxjerrë edhe këto akte:

- Rregullore,
- Vendime,
- Udhëzime,
- Rekomandime.

## 5. ANTARËSIMI

##### **Neni 11**

Anëtarësimi në Lëvizjen BESA është i bazuar në vullnetin e vetë qytetarëve të R. së Maqedonisë.

Lëvizja BESA është subjekt politik dhe i hapur për të gjithë qytetarët e R. së Maqedonisë.

Anëtarë i Lëvizjes BESA mund të bëhet çdo qytetar i cili ka fituar pjekurinë ligjore gjegjësisht ka plotësuar moshën 18 vjeçare dhe i cili pranon dispozitat e këtij Statuti, Programit dhe akteve të Lëvizjes BESA.

Çdo anëtarë duhet të nënshkruajë deklaratën apo fletë-anëtarësimin në Lëvizjen BESA.

Anëtari i Lëvizjes BESA duhet të mbrojë dhe të promovojë politikën e Lëvizjes në të gjitha format e organizimit dhe të veprimit politik.

Anëtari i Lëvizjes BESA nuk mund të njëkohësisht të jetë edhe anëtarë i ndonjë subjekti tjetër politik.

#### 5.1. Procedura e anëtarësimi

## **Neni 12**

I interesuari për anëtarësim mund të anëtarësohet pasi të këtë plotësuar dhe të ketë dorëzuar formularin për anëtarësim.

Formulari për anëtarësim mund të dorëzohet në këshillin vendor, në këshillin komunal, në ueb faqen zyrtare, ose në selinë qendrore të Lëvizjes BESA.

Për pranimin e anëtarit në Lëvizjen BESA vendos Kryesia e Këshillit vendor brenda dy javësh nga aplikimi.

Anëtari i pranuar pajiset me kartelën e anëtarësisë dhe evidentohet në regjistrat e anëtarësisë së këshillit vendor, në formë të shkruar ose elektronike.

Në rast të refuzimit të kërkesës për pranim, aplikanti ka të drejtë të ankohet në Kryesinë e Lëvizjes BESA. Vendimi i Kryesisë është përfundimtar.

Çdo anëtar i Lëvizjes BESA mund të jetë anëtar i vetëm një këshilli vendor.

## **5.2. Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve**

### **Neni 13**

Secili anëtar i Lëvizjes BESA i ka këto të drejta dhe detyrime:

- të marrë pjesë në përcaktimin dhe në realizimin e politikave të Lëvizjes;
- të ndërmarrë nisma që janë në pajtim me Statutin dhe Programin e Lëvizjes BESA dhe t'ua prezantojë organeve vendimmarrëse;
- të zgjedhë dhe të zgjedhet në organet e Lëvizjes BESA;
- lirisht të shprehë mendimin e vet në suazat e Lëvizjes;
- të angazhohet në fushatën zgjedhore për sukses të Lëvizjes në zgjedhje,
- të paguajë anëtarësinë;
- të propozohet si kandidat i Lëvizjes BESA në listat zgjedhore për zgjedhje lokale, parlamentar apo presidenciale;
- të jetë i informuar për punën e organeve të Lëvizjes BESA;
- të marrë pjesë në aktivitetet përkatëse të Lëvizjes BESA;
- t'i përhap dhe të propagandojë përcaktimet programore dhe qëndrimet politike të Lëvizjes;
- të realizojë të drejtat dhe të përmbushë obligimet tjera të parapara me Program, me Statut dhe me akte e vendime të tjera.



**Neni 14**

Anëtari i Lëvizjes BESA e humb statusin e anëtarit në këto raste:

- Me dorëheqje vullnetare,
- Në rast përjashtimi nga ana e organeve të Lëvizjes BESA,
- Nëse e humb aftësinë e plotë të veprimit;
- Nëse ai vdes.

Kërkesa për dorëheqje nga anëtarësia i drejtohet Kryesisë së Këshillit vendor.

Anëtari përjashtohet nga Lëvizja kur e shkel Statutin ose Programin e Lëvizjes, bën keqpërdorim e mjeteve financiare dhe kur me veprimet e tij e dëmton prestigjin e Lëvizjes.

Pas përjashtimit ose tërheqjes së anëtarit, largimi evidentohet në regjistrat bazë të Lëvizjes BESA.

Kompetent për përjashtimin e anëtarit nga Lëvizja BESA është organi që e ka pranuar. Anëtarit të përjashtuar i dorëzohet vendimi me shkrim, menjëherë pas nxjerrjes së tij.

Anëtari i përjashtuar me vendim, mund të ankohet në organet qendrore të Lëvizjes BESA, përkatësisht në Këshillin Drejtues ose në Kryesinë e Lëvizjes BESA në afat prej 8 (tetë) ditësh nga momenti i marrjes së vendimit.

**6. ORGANIZIMI I LËVIZJES BESA****Neni 15**

Lëvizja BESA organizohet në bazë të parimit territorial edhe atë në gjithë territorin e R. së Maqedonisë.

Lëvizja BESA si lëvizje politike dhe anëtarësia e saj është e organizuar në organe lokale dhe qendrore.

**Neni 16**

Organet Lokale të Lëvizjes BESA janë të organizuara në këtë mënyrë:

- Në nivel lokal – Këshilli vendor
- Në nivel komunal – Këshilli komunal;

**Neni 17**

Organet qendrore të Lëvizjes BESA janë të organizuara në këtë mënyrë:

- Kongresi;
- Kryetari;
- Këshilli Qendror;
- Kryesia Qendrore;
- Këshilli Mbikëqyrës.

**7. ORGANET LOKALE**

## **7.1. Këshilli vendor**

### **Neni 18**

Këshilli Vendor është njësi më e vogël e organizimit të Lëvizjes BESA, që organizohet mbi baza lagjeje, vendvotimi ose lokaliteti të caktuar.

Ky organ themelohet nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Këshillit vendor me vendim paraprak të Kryesisë së Këshillit komunal të Lëvizjes BESA.

Kryesia e Këshillit komunal të Lëvizjes BESA sjell vendim për themelim të Këshillit vendor përkatës nëse atë e kërkojnë së paku 10 anëtarë të asaj, të cilët jetojnë në atë vendbanim.

Territori i veprimtarisë së Këshillit vendor përcaktohet me vendim për themelimin e saj.

### **Neni 19**

Organet e Këshillit vendor janë:

- Kuvendi i Këshillit vendor;
- Kryesia e Këshillit vendor;
- Kryetari i Këshillit vendor dhe
- Këshilli mbikëqyrës i Këshillit vendor.

## **7.2. Kuvendi i Këshillit vendor**

### **Neni 20**

Kuvendi Këshillit vendor është organi më i lartë i Këshillit vendor.

Kuvendi i Këshillit vendor përbëhet nga të gjithë anëtarët e Lëvizjes BESA në atë Këshill vendor.

Kryetari i Këshillit vendor njëherësh është edhe kryetar i Kuvendit të atij Këshilli vendor.

### **Neni 21**

Kuvendi i Këshillit vendor thirr mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Mbledhjet e rregullta i thërret kryetari i Këshillit vendor, njëherë në 6 (gjashtë) muaj, kurse ato të jashtëzakonshme sipas nevojës. Për mbajtjen e çdo mbledhje duhet të vendosë Kryesia e Këshillit vendor.

Kryetari i Kuvendit është i obliguar të thërret mbledhje nëse atë e kërkojnë së paku 1/3 e kuvendarëve.

Kuvendi i Këshillit vendor zgjedhë Kryesinë e Këshillit vendor.

Kuvendi i Këshillit vendor propozon kandidatë për Kryetar komune, listë të kandidatëve për këshilltar komunal, kandidatë për Deputet, kandidatë për funksione të ndryshme lokale dhe shtetërore me rëndësi, emëron kandidatë për delegatë në Kongres, etj.

### **7.3. Kryesia e Këshillit vendor**

#### **Neni 22**

Kryesia e Këshillit vendor përbëhet prej së paku 5 (pesë) anëtarë. Anëtarët e Kryesisë së Këshillit vendor zgjidhen në një mandat prej 4 vjetësh, me të drejtë rizgjedhjeje.

Kryesia e Këshillit vendor zgjidhet nga ana e Kuvendit të Këshillit vendor.

Kryetari i Forumit rinor të atij Këshilli vendor dhe Kryetari i Forumit të Gruas të atij Këshilli vendor me automatizëm janë anëtar të Kryesisë së Këshillit Vendor.

Mbledhjet e Kryesisë së Këshillit vendor i fton Kryetari i Këshillit vendor. Kryetari obligohet që të ftojë mbledhje edhe nëse atë e kërkon 1/3 e anëtarëve të Kryesisë së Këshillit vendor.

Me mbledhjet e Kryesisë së Këshillit vendor udhëheq Kryetari i saj, kurse në mungesë të tij njëri nga nënkryetarët, paraprakisht i autorizuar nga Kryetari i Këshillit vendor.

Kryesia mund të marrë vendime nëse në atë mbledhje ka kuorum, të ftuar në mënyrë të rregullt nga Kryetari i Këshillit vendor.

Kryesia e Këshillit vendor nga radhët e veta zgjedh Nënkyetar, Sekretar dhe Arkëtar të Këshillit vendor, me propozim të Kryetarit të Këshillit vendor.

Sekretari organizon dhe ruan dokumentacionin e Këshillit vendor si dhe përgatit mbledhjet e Këshillit vendor. Sekretari kryen edhe punë tjera të cilat ia beson Kryetari i Këshillit vendor.

Kryesia e Këshillit vendor është kompetente për të vendosur për kontaktet me anëtarë të Lëvizjes, për gjendjen e Lëvizjes në terren, për marrjen e masave disiplinore ndaj secilit anëtar të Lëvizjes.

Numri i anëtarëve dhe forma e organizimit të kryesisë së këshillave vendor përcaktohet nga kuvendi i këshillit komunal përkatës me rregullore të veçantë.

### **7.4. Kryetari i Këshillit vendor**

#### **Neni 23**

Kryetari i Këshillit vendor e përfaqëson Këshillit vendor në të gjitha organet e Lëvizjes BESA.

Kryetari i Këshillit vendor zgjidhet nga ana e Kuvendit të Këshillit vendor me shumicë votash, me mandat 4 vjeçar. Kryetari i Këshillit vendor ka të drejtë në rizgjedhje vetëm edhe në një mandat tjetër.

Kryetari i Këshillit vendor me automatizëm është edhe kryetar i Kryesisë së Këshillit vendor.

Ai është përgjegjës për koordinimin e të gjitha punëve të Këshillit vendor në kuadër të vet, i fton dhe udhëheq me mbledhjet dhe realizon të gjitha vendimet me rëndësi për Lëvizjen.

### **7.5. Këshilli mbikëqyrës i Këshillit vendor**

#### **Neni 24**

Këshilli mbikëqyrës i Këshillit vendor është organ që emërohet nga Kryesia e Këshillit Komunal të Lëvizjes BESA, bën kontrollimin e gjendjes së dokumentacionit në përgjithësi e mënyrën materialo-financiare të Këshillit vendor në veçanti.

Këshilli mbikëqyrës përbëhet prej 3 anëtarëve dhe zgjidhet në mandate prej 4 (katër) vjetësh.

Këshilli mbikëqyrës në mbledhjen e saj të parë zgjedh kryetar me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Këshilli mbikëqyrës i Këshillit vendor për punën e vet i jep raport Kryesisë së Këshillit Komunal dhe njëherësh informon kuvendin e Këshillit vendor të cilës i takon.

### **7.6. Këshilli Komunal**

#### **Neni 25**

Këshilli Komunal është forma më e lartë e organizimit në nivel lokal të Lëvizjes BESA.

Organ kompetent për themelimin e Këshillit Komunal është Këshilli Qendror i Lëvizjes BESA, i cili për një gjë të tillë sjell vendim.

#### **Neni 26**

Organet e Këshillit Komunal janë:

- Kuvendi i Këshillit Komunal;
- Kryesia e Këshillit Komunal;
- Kryetari i Këshillit Komunal dhe
- Këshilli mbikëqyrës i Këshillit Komunal.

### **7.7. Kuvendi i Këshillit Komunal**

#### **Neni 27**

Kuvendi i Këshillit Komunal së Lëvizjes BESA si formë e organizimit komunal paraqet organin më të lartë të Këshillit Komunal në komunën gjegjëse.

Kuvendi i Këshillit Komunal është përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e Këshillave vendor që gjenden në territorin e vet.

Kuvendi i Këshillit Komunal përbëhet prej së paku 17 anëtarë. Anëtarët e Kuvendit të Këshillit Komunal janë anëtarë të regjistruar paraprakisht si anëtarë të Këshillave vendor të Lëvizjes BESA në atë komunë.

Kuvendi me propozim paraprak të kryesive të Këshillave vendor të komunës përkatëse, zgjedh dhe emëron Kryetar të Këshillit Komunal të asaj komune me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm edhe një mandat.

Kryetari i Këshillit Komunal zgjidhet me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit të Këshillit Komunal.

Numri dhe mënyra e delegimit të anëtarëve të Kuvendit të Këshillit Komunal përcaktohet me Rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli Qendror.

### **Neni 28**

Anëtarë të Kuvendit të Këshillit Komunal me automatizëm janë:

- Kryetarët e Këshillave vendor në territorin e asaj komune;
- Kryetari i Forumit Rinor i Këshillit Komunal;
- Kryetari i Forumit të Gruas të Këshillit Komunal.

## **7.8. Mbledhjet e Kuvendit të Këshillit Komunal**

### **Neni 29**

Mbledhjet e Kuvendit të Këshillit Komunal i thirr dhe me to udhëheq kryetari i Këshillit Komunal.

Kuvendi i Këshillit Komunal mbledhet sipas nevojës, kurse së paku një herë në 6 (gjashtë) muaj.

Kryetari i Këshillit Komunal obligohet të thërret mbledhje nëse atë e kërkojnë së paku 1/3 e anëtarëve të Kuvendit të Këshillit komunal, Kryesisë Qendrore si dhe nëse atë e kërkon më së paku 1/3 e kuvendeve të Këshillave vendor.

Në Kuvendin e Këshillit Komunal marrin pjesë të gjithë funksionarët në organet shtetërore nga radhët e Lëvizjes BESA, të atij Këshillit Komunal me të drejtë vote.

Kryetari i Këshillit Komunal para çdo zgjedhje është i obliguar ta thirr Kuvendin e Këshillit Komunal, për të propozuar kandidaturat për përfaqësues në organet komunale, parlamentare dhe republikane si dhe të thirr mbledhje pas zgjedhjeve për të analizuar rezultatet e atyre zgjedhjeve.

Propozimi për mbledhje të Kuvendit bëhet në formë të shkruar me arsyetim dhe ju dorëzohet të gjithë anëtarëve të Kuvendit, së paku 3 (tre) ditë para mbledhjes.

Kuvendi mund të punojë nëse në mbledhje marrin pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, kurse mund të vendos me shumicë votash të anëtarëve prezent në atë mbledhje.

## **7.9. Të drejtat dhe detyrimet e Kuvendit të Këshillit Komunal**

### **Neni 30**

Kuvendi:

- Miraton Rregullore për punën e Kuvendit të Këshillit Komunal si dhe rregullore tjera sipas nevojës;
- Zgjedh Kryetarin e Këshillit Komunal të Lëvizjes BESA;
- Me propozim të Kryetarit të Këshillit komunal, zgjedh anëtarët e Kryesisë së Këshillit Komunal;
- Zgjedh kandidatë në të gjitha organet e Lëvizjes BESA në nivel të Këshillit Komunal;

- Propozon kandidatë për përfaqësues në Këshillin Qendror të Lëvizjes BESA;
- Miraton propozimet e Këshillave vendor për kandidaturat e funksioneve të ndryshme në nivel komunal;
- Deri te Këshilli Qendror propozon listën e kandidaturave për deputetë, ministra, Zv.ministra, president shteti, kryetar për Qytetin e Shkupit.
- Deri te Kryesia Qendrore propozon listën e kandidaturave për funksione publike në nivel qendror dhe në kuadër të Qytetit të Shkupit;
- Formon komisione të ndryshme të Këshillit Komunal;
- Bën edhe punë tjera në përputhje me vendimet e marra nga ana e organeve qendrore të Lëvizjes BESA.

## 7.10. Kryesia e Këshillit Komunal

### Neni 31

Kryesia e Këshillit Komunal është trupi ekzekutiv – politik, në krye me Kryetarin e Këshillit Komunal. Ajo e udhëheq punën në Këshillin Komunal.

Kryesia e Këshillit Komunal zgjidhet në mbledhje të rregullt të Kuvendit dhe përbëhet nga së paku 9 (nëntë) anëtar. Numri i anëtarëve të Kryesisë së Këshillit Komunal përcaktohet nga Kryesia Qendrore e Lëvizjes BESA.

Nga radhët e veta zgjedh Nënkryetar të Këshillit Komunal, me propozim paraprak të Kryetarit të Këshillit Komunal, me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Kryetari i Forumit Rinor dhe Forumit të Gruas, sipas detyrës zyrtare, janë anëtarë të Kryesisë së Këshillit Komunal me të drejtë vote.

Mbledhjet e Kryesisë i thirr dhe me to udhëheq Kryetari i Këshillit Komunal.

Në rast mungese të Kryetarit të Këshillit Komunal, në mbledhjen e kryesisë kryeson, njëri nga Nënkryetarët i autorizuar paraprakisht nga kryetari i Këshillit Komunal.

Kryetari i Këshillit Komunal obligohet ti thërret mbledhjet e Kryesisë me kërkesën e 2/3 të anëtarëve të Kryesisë. Rendi i ditës i mbledhjes duhet të përcaktohet në kërkesën e paraqitur në formë të shkruar. Mbledhja mbahet brenda 10 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

### Neni 32

Kryesia e Këshillit Komunal:

- Miraton Rregullore për punën e vet;
- Kujdeset për zbatimin e vendimeve të Kuvendit të këshillit komunal;
- Mobilizon strukturat e Këshillit Komunal përkatës;
- Organizon proceset zgjedhore në Këshillin Komunal përkatës;
- Deri te Kuvendi i Këshillit komunal propozon kandidatë për këshilltar komunal;
- Deri te Kuvendi i Këshillit komunal propozon kandidat për Kryetar komune;
- Deri te Kuvendi i Këshillit komunal propozon kandidatë për deputet;
- Deri te Kuvendi i Këshillit komunal propozon kandidat për funksionarë ekzekutiv dhe funksione tjera publike;

- Realizon obligimet programore të Lëvizjes BESA;
- Zgjedh Sekretarin dhe Përgjegjësin financiar të Këshillit Komunal;
- Zgjedh anëtarët e Këshillave mbikëqyrës të Këshillave vendor në kuadër të Këshillit Komunal përkatës;
- Miraton planet e të ardhurave dhe shpenzimeve të Këshillit Komunal;
- Përpilon plane për punën vjetore të Këshillit Komunal;
- Me autorizim të Kuvendit të Këshillit komunal i adreson propozimet dhe kërkesat në emër të Këshillit Komunal në organet qendrore të Lëvizjes BESA;
- Në kuadër të Këshillit Komunal krijon grupe ekspertësh për çështje të caktuara profesionale, në të cilat mund të marrin pjesë edhe njerëz që nuk janë anëtar të Lëvizjes BESA.
- Bën edhe punë të tjera që ia përcakton Kuvendi i Këshillit Komunal të Lëvizjes BESA.

### **7.11. Kryetari i Këshillit Komunal**

#### **Neni 33**

Kryetari i Këshillit Komunal përfaqëson Këshillin Komunal të Lëvizjes BESA.

Kryetari i Këshillit Komunal zgjidhet nga Kuvendi i Këshillit Komunal me shumicë votash, me mandat prej 4 (katër) vjetësh, me të drejtë vetëm edhe në një rizgjedhje.

Kryetari i Këshillit Komunal udhëheq me mbledhjet e Kuvendit dhe Kryesisë së Këshillit Komunal përkatës.

I nënshkruan aktet që i nxjerrin organet e Këshillit Komunal dhe kujdeset për realizimin e tyre.

Është përgjegjës për zbatimin e politikave të përgjithshme të Lëvizjes BESA në nivel të Këshillit Komunal.

Kryetari i Këshillit Komunal për punën e vet në nivel lokal raporton para Kuvendit të Këshillit Komunal kurse në nivel qendror para Kryetarit të Lëvizjes BESA.

### **7.12. Sekretari i Këshillit Komunal**

#### **Neni 34**

Çdo Këshill Komunal ka Sekretarin e vet, i cili emërohet nga Kryesia e këshillit komunal, të Lëvizjes BESA sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e brendshme, me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Sekretari ka për detyrë zbatimin e vendimeve të organeve të Lëvizjes BESA në komunën përkatëse. Ai ndihmon në organizimin e zgjedhjeve në territorin e komunës përkatëse.

Për çdo vit ai mban një raport të detajuar të punës së tij.

Çdo fund vit, sekretari i Këshillit Komunal i paraqet kryesisë së Këshillit Komunal një raport të veprimtarive ku veçanërisht përfshihen:

- Anëtarësimet;
- Financimi i Lëvizjes
- Jeta e strukturave të Lëvizjes.

Sekretari i Këshillit Komunal është anëtar me të drejtë vote në Kryesinë e Këshillit Komunal.

### **7.13. Këshilli mbikëqyrës i Këshillit Komunal**

#### **Neni 35**

Këshilli mbikëqyrës i Këshillit Komunal të Lëvizjes BESA është organ që bën kontrollimin, përputhjen respektivisht mbikëqyrjen e akteve dhe vendimeve me Statutin, si dhe kontrollon gjendjen materialo- financiare të Këshillave vendore në territorin e atij Këshilli komunal.

Këshilli mbikëqyrës i Këshillit Komunal të Lëvizjes BESA përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve dhe nga radhët e veta zgjedh kryetar me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës i zgjedh Kryesia Qendrore, me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të këshillit komunal, marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Këshillit Komunal, pa të drejta vote;

Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës kanë të drejtë në rizgjedhje.

Këshilli mbikëqyrës i Këshillit Komunal për punë e vet i jep raport Kryesisë Qendrore.

## **8. ORGANET QENDRORE TË BESA**

### **8.1.**

#### **Kongresi**

#### **Neni 36**

Kongresi është organi më i lartë i Lëvizjes BESA.

Anëtarët e Kongresit zgjedhën me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Çdo anëtar i Kongresit paraprakisht duhet të jetë anëtar i Lëvizjes BESA.

Kongresi mbahet në takime të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Takimet e rregullta mbahen një herë në 4 vjet.

Vendimin për mbledhjen e Kongresit e merr Këshilli Qendror me propozimin e Kryetarit të Lëvizjes BESA. Pas këtij vendimi Këshilli Qendror i Lëvizjes BESA formon Komision për organizimin e Kongresit, i cili drejton mbarëvajtjen e Kongresit.

Data e zhvillimit të Kongresit dhe rendi i ditës njoftohet në formë të shkruar, së paku 1 (një) muaj para mbajtjes së ditës së Kongresit.

Të gjitha kërkesat apo propozimet që vijnë nga organet e Lëvizjes BESA për t'u futur në rend të ditës në Kongres, duhet t'i dorëzohen Komision për organizimin e Kongresit të Lëvizjes BESA së paku dy javë para mbajtjes së Kongresit.

Kongresi merr vendime nëse në takim janë prezent shumica e anëtarëve respektivisht delegatëve të ftuar zyrtarisht.



Për të gjitha propozimet e parashtruara në Kongres, ky i fundit vendos nëse ato propozime i përkrahin shumica e anëtarëve pjesëmarrës të atij Kongresi të Lëvizjes BESA.

Puna dhe mënyra e organizimit të Kongresit definohet me Rregullore të veçantë të cilën e miratojnë anëtarët e Kongresit me shumicë votash nga delegatët pjesëmarrës.

Për numrin e delegatëve të Kongresit si dhe mënyrën e delegimit në kongres, Këshilli Qendror sjellë rregullore të veçantë.

### **8.1.1. Përbërja e Kongresit**

#### **Neni 37**

Kongresi përbëhet nga:

- Delegatët e deleguar në bazë të rregullores të sjellë nga ana e Këshillit Qendror;
- Anëtarët e Këshillit Qendror aktual të Lëvizjes BESA;
- Ministrat nga radhët e Lëvizjes BESA;
- Deputetët e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë nga radhët e Lëvizjes BESA;
- Kryetarët e Komunave nga radhët e Lëvizjes BESA;
- Kryesia e Forumit Rinor në nivel qendror të Lëvizjes BESA;
- Kryesia e Forumit të Gruas në nivel qendror të Lëvizjes BESA.

### **8.1.2. Kompetencat e Kongresit**

#### **Neni 38**

Kongresi ka këto kompetenca:

- Miraton Statutin e Lëvizjes BESA dhe ndryshimet e tij;
- Miraton Rregulloren e punës së Kongresit;
- Miraton Programin e Lëvizjes BESA;
- Zgjedh Kryetarin e Lëvizjes BESA;
- Zgjedh anëtarët e Këshillit Qendror të Lëvizjes BESA;
- Formon Këshillin mbikëqyrës Qendror të Lëvizjes BESA;
- Miraton Rezolutat;
- Shqyrton raportin e punës dhe atë financiar të Lëvizjes BESA midis dy kongreseve;
- Vendos për shkarkimin e Kryetarit të Lëvizjes mbi bazën e një mocioni mosbesimi të miratuar nga 2/3 e anëtarëve të Kongresit;
- Vendos edhe për punë tjera të cilat i përcakton Rregullorja e punës së Kongresit dhe ky Statut.

### **8.1.3. Kongresi i jashtëzakonshëm**

#### **Neni 39**

Kongresi mund të thirret edhe në mbledhje të jashtëzakonshme.

Kongresi në mbledhje të jashtëzakonshme thirret me kërkesë të Kryetarit të Lëvizjes BESA, ose me kërkesë të së paku 1/2 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Qendror. Në këtë rast Kryesia Qendrore e Lëvizjes BESA njofton brenda 2 (dy) javësh rendin e ditës dhe datën e Kongresit.

Materialet për Kongresin e jashtëzakonshëm anëtarëve u dërgohen në formë të shkruar, një javë para mbledhjes.

Sa i përket organizimit dhe çështjeve tjera në lidhje me Kongresin e jashtëzakonshëm vlejné normat e këtij statuti që vlejné edhe për kongresin e rregullt.

## **9. KËSHILLI QENDROR**

### **Neni 40**

Këshilli Qendror është organi më i lartë i Lëvizjes BESA në mes të dy kongreseve.

Këshilli Qendror i Lëvizjes BESA ka anëtarë të zgjedhur si dhe anëtarë në bazë të pozicionit.

Numri i anëtarëve të zgjedhur është 80.

Anëtarë në bazë të pozicionit janë funksionarë të Lëvizjes BESA në organet shtetërore dhe lokale (deputet, ministra, Kryetari i Qytetit të Shkupit si dhe Kryetarët e komunave).

Anëtarët e Këshillit Qendror që i zgjedh Kongresi me vota të fshehta, janë me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Propozimin më shkrim për anëtarë të Këshillit Qendror e bën Kryetari i Lëvizjes si dhe së paku 10 delegatë të Kongresit.

Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve, punës dhe mënyrës së organizimit të Këshillit Qendror rregullohet me Rregullore të veçantë që e sjellë Këshilli Qendror i Lëvizjes BESA.

### **9.1. Përbërja e Këshillit Qendror**

#### **Neni 41**

Këshilli Qendror i Lëvizjes BESA përbëhet nga:

- Kryetari i Lëvizjes BESA;
- Nënkryetarët Lëvizjes BESA;
- Sekretari Gjeneral;
- Anëtarët e tjerë Kryesisë Qendrore;
- Sekretarët e Sekretariateve të Lëvizjes BESA;
- Kryetarët e Këshillave Komunal;
- Kryetari i Forumit të Gruas;
- Kryetari i Forumit Rinor;
- Funksionarë të Lëvizjes BESA në organet shtetërore dhe lokale;
- Anëtarët e zgjedhur nga Kongresi.

## 9.2. Mbledhjet dhe vendimmarrja e Këshillit Qendror

### Neni 42

Këshilli Qendror mban mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Mbledhjet e rregullta mbahen së paku një herë në 6 (gjashtë) muaj dhe debatohet sipas një rend dite të vendosur nga Kryesia Qendrore.

Këshilli Qendror punon nëse në mbledhje marrin pjesë shumica e anëtarëve të saj.

Këshilli Qendror vendos për çështjet e parapara në rend të ditës, me shumicë të votave nga anëtarët prezent.

Këshilli Qendror thirret dhe udhëhiqet nga Kryetari i Lëvizjes BESA.

Kryetari obligohet të thirr mbledhje të Këshillit Qendror nëse atë e kërkon Kryesia Qendrore ose nëse një gjë të tillë e kërkojnë 1/3 e anëtarëve të Këshillit Qendror.

Për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta, anëtarët e Këshillit Qendror duhet të njoftohen së paku 7 (shtatë) ditë paraprakisht, ndërsa për mbajtjen e mbledhjeve të jashtëzakonshme anëtarët duhet të njoftohen së paku 2 (dy) ditë paraprakisht.

## 9.3. Kompetencat e Këshillit Qendror

### Neni 43

Këshilli Qendror ka këto kompetenca:

- Jep propozimet për Program dhe Statut të Lëvizjes BESA;
- Udhëheq me punën e Lëvizjes mes dy kongreseve;
- Miraton Rregulloren për punën e vet dhe planet e tjera;
- Cakton numrin e Nënkryetarëve të Lëvizjes BESA;
- Zgjedh anëtarët e Kryesisë Qendrore të Lëvizjes BESA;
- Zgjedh komisione të përkohshme, këshilla dhe trupa punuese nga lëmenj të ndryshëm, në pajtim me Statutin;
- Vendos për bashkëpunimin me subjektet tjera politike;
- Vendos për lidhjen e koalicioneve para dhe pas zgjedhore;
- Miraton llogarinë përfundimtare dhe buxhetin për vitin vijues;
- Verifikon listën e kandidatëve për deputetë, si dhe kandidatët për funksione tjera shtetërore;
- Vendos për caktimin e datës së mbajtjes së Kongresit të Lëvizjes BESA;
- Formon Komision për organizimin e Kongresit të Lëvizjes BESA;
- Miraton Programin dhe Platformën Zgjedhore të Lëvizjes BESA;
- Zgjedh Shtabin Qendror Zgjedhor dhe kryetarin e ShQZ-së të Lëvizjes BESA dhe përcakton mënyrën organizative të saj;
- Merr qëndrime politike;
- Nxjerrë rregullore për mënyrën e themelimit, ngrirjes dhe shpërbërjes së Këshillave komunale të Lëvizjes BESA;
- Nxjerr rregullore për mënyrën e formimit, ngrirjes dhe shpërbërjes së Sekretariateve për çështje të caktuara;

- Vendosë edhe për çështjet tjera të përcaktuara me Statut dhe Rregulloren e punës.

## **10. KRYETARI I LËVIZJES BESA**

### **Neni 44**

Kryetari është udhëheqës dhe përfaqësues i të gjithë anëtarëve të Lëvizjes BESA.

Kryetari zgjidhet me vota të fshehta nga Kongresi i Lëvizjes BESA, me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë vetëm edhe në një rizgjedhje.

Propozimin për kryetar të Lëvizjes BESA e bën çdo delegat i kongresit i përkrahur nga se paku 1/10 e delegatëve të kongresit. Një delegat ka të drejtë të përkrah vetëm një kandidat për kryetar

Për Kryetar i Lëvizjes BESA zgjidhet kandidati i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i delegatëve pjesëmarrës në Kongresit.

Nëse ka më shumë kandidatë për Kryetar të Lëvizjes BESA, delegatët e Kongresit votojnë për të gjithë kandidatët. Dy kandidatët që kanë marrë më së shumti vota nga ky votim, rivotohen edhe një herë. Në këtë garë të të dy kandidatëve, fitues respektivisht Kryetar shpallet ai i cili merr më shumë vota nga delegatët e Kongresit.

Kryetari për punën e vet i përgjigjet Kongresit të Lëvizjes BESA.

Në rast pamundësie të ushtrimit të detyrës së Kryetarit, atë e zëvendëson njëri nga Nënkryetarët, për të cilën gjë vendos Kryetari i Lëvizjes BESA, ose në pamundësi të kryetarit vendos Këshilli Qendror.

### **10.1. Kompetencat e Kryetarit**

#### **Neni 45**

Kryetari:

- Përfaqëson Lëvizjen BESA në të gjitha organet vendore dhe ndërkombëtare;
- Udhëheq punën e organeve të Lëvizjes BESA;
- Thërret dhe udhëheq mbledhjet e Këshillit dhe Kryesisë Qendrore;
- Kujdeset për realizimin e normave Statutare dhe akteve tjera;
- Propozon kandidatët për Nënkryetarë të Lëvizjes BESA;
- Propozon kandidat për Sekretar Gjeneral të Lëvizjes BESA;
- Propozon anëtarët në Sekretariatet e Lëvizjes BESA;
- Propozon listën e kandidatëve për anëtar të Këshillit Qendror;
- Propozon anëtarët e Kryesisë Qendrore;
- Propozon përbërjen e delegacioneve të Lëvizjes BESA për takime brenda dhe jashtë shtetit;
- Me pëlqim të Kryesisë Qendrore, dorëzon listën përfundimtare të kandidatëve për deputet të Lëvizjes BESA në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë;
- Pas miratimit nga Këshilli Qendror, dorëzon listën përfundimtare të kandidatëve të Lëvizjes BESA edhe për të gjitha funksionet tjera publike respektivisht shtetërore të Republikës së Maqedonisë;
- Me pëlqim të Këshillit Qendror vendos të hyj në koalicion para apo pas zgjedhor;

- Kryen punë të tjera, të parapara me Statut dhe Rregullore.

## **10.2. Nënkyetarët e Lëvizjes BESA**

### **Neni 46**

Kandidatë për Nënkyetar propozon Kryetari nga rrathët e Kryesisë Qendrore të Lëvizjes BESA.

Nënkyetarët zgjidhen me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kryesisë Qendrore të Lëvizjes BESA.

Nënkyetarët zgjidhen me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Nënkyetarët e Lëvizjes BESA për punën e tyre përgjigjen para Kryesisë Qendrore të Lëvizjes BESA.

Në mungesë të Kryetarit dhe me autorizim të tij, njëri prej tyre zëvendëson Kryetarin.

Në mungesë të këtij autorizimin (dorëheqje, humbje aftësisë së plotë të veprimit, vdekje), Sekretari i Gjeneral e mbledh Kryesinë Qendrore i cila zgjedh Nënkyetarin që do të drejtojë Lëvizjen BESA deri në vendimin përfundimtar të Kongresit.

## **11. KRYESIA QENDRORE**

### **Neni 47**

Kryesia Qendrore është organ ekzekutiv dhe menaxhues i Lëvizjes BESA.

Kryesia Qendrore mban mbledhje sipas nevojës, ose së paku njëherë në muaj. Mbledhjet i thërret dhe me to udhëheq Kryetari i Lëvizjes. Mbledhja mund të mbahet nëse në të janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të kryesisë të ftuar në mënyrë të rregullt.

Kryetari i lëvizjes BESA obligohet të thërret mbledhje të kryesisë nëse këtë e kërkojnë së paku 1/3 e anëtarëve të Kryesisë Qendrore.

Kryesia Qendrore përbëhet nga së paku 21 (njëzet e një) anëtarë.

Vendimet në Kryesinë Qendrore merren me shumicë votash.

### **Neni 48**

Kryesia Qendrore përbëhet nga:

- Kryetari;
- Nënkyetarët;
- Sekretari Gjeneral;
- Anëtarët e tjerë të emëruar nga Këshilli Qendror.

### **Neni 49**

Mandati i anëtarëve të Kryesisë Qendrore është 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Anëtarët e Kryesisë Qendrore i zgjedh Këshilli Qendror, me propozim të Kryetarit të Lëvizjes.

Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Kryesisë bëhet me votim të fshehtë, përveç se kur Këshilli Qendror vendos ndryshe.

Numri dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Kryesisë qendrore do të përcaktohet me Rregullore të veçantë që e nxjerrë Këshilli Qendror.

### **11.1. Kompetencat e Kryesisë Qendrore**

#### **Neni 50**

Kryesia Qendrore:

- Nga rrathët e veta emëron dhe shkarkon Nënkryetarët e Lëvizjes BESA;
- Nga rrathët e veta emëron dhe shkarkon Sekretarin Gjeneral;
- Emëron dhe shkarkon anëtarët e Sekretariateve të Lëvizjes BESA;
- I përcjell dhe realizon zgjedhjet e Kryesisë së Këshillave Komunal;
- I propozon listën përfundimtare Këshillit Qendror për kandidatë në zgjedhjet lokale, parlamentare dhe republikane;
- I propozon listën përfundimtare Këshillit Qendror për kandidatë-bartës të funksioneve shtetërore;
- Menaxhon të gjitha mjetet financiare dhe pasurinë tjetër në nivel qendror;
- Kontrollon menaxhimin e pasurisë edhe në nivele tjera të strukturave të Lëvizjes BESA;
- Jep pëlqimin për raportin përfundimtar financiar që miratohet nga Këshilli Qendror;
- Ndërhynë në politikat e Këshillave Komunal në rast se ato bllokohen gjatë punës së tyre
- Aprovon dhe rekomandon botime për nevoja të caktuara të Lëvizjes BESA;
- Kryen edhe punë tjera të përcaktuara me Rregulloren e punës dhe këtë Statut.

### **12. KËSHILLI MBIKËQYRËS QENDROR I LËVIZJES BESA**

#### **Neni 51**

Këshilli mbikëqyrës Qendror i Lëvizjes BESA është organ më i lartë i cili bën kontrollimin dhe vlerësimin e akteve juridike si dhe përputhjen respektivisht mbikëqyrjen e akteve dhe vendimeve me Statutin, dhe mënyrën e shpenzimeve dhe raporteve financiare, të organeve qendrore të Lëvizjes BESA

Këshilli mbikëqyrës qendror mban mbledhje sipas nevojës, së paku 2 (dy) herë gjatë vitit.

Këshilli mbikëqyrës qendror i Lëvizjes BESA përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve dhe nga radhët e veta në mbledhjen e parë të saj zgjedh kryetar.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës qendror i zgjedh Kongresi i Lëvizjes, me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Ky këshill qendror mbi për punën e vet i raporton Kongresit dhe Këshillit Qendror.

Këshilli mbikëqyrës qendror për punën e vet do të përpilon Rregullore.

## **13. SEKRETARI GJENERAL**

### **Neni 52**

Sekretari Gjeneral organizon funksionimin e përditshëm të Lëvizjes dhe përgjigjet për organizimin e saj. Është udhëheqës i administratës së Lëvizjes BESA si dhe është zyrtari më i lartë administrativ i Lëvizjes BESA.

Sekretari Gjeneral propozohet nga Kryetari kurse zgjidhet dhe shkarkohet me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kryesisë Qendrore të Lëvizjes BESA.

Sekretari Gjeneral zgjidhet nga rrathët e Kryesisë Qendrore të Lëvizjes, me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Kandidat për Sekretar Gjeneral propozojnë edhe e anëtarët e Kryesisë Qendrore

Përcjell administrimin e buxhetit të Lëvizjes BESA dhe çdo 3 (tre) muaj e njofton Kryesinë Qendrore për gjendjen financiare të Lëvizjes BESA.

### **13.1. Kompetencat e Sekretarit Gjeneral**

#### **Neni 53**

Sekretari Gjeneral:

- Organizon dhe udhëheq Selinë Qendrore dhe rajonale të Lëvizjes BESA;
- Organizon dhe kujdeset për funksionimin e administratës;
- Organizon dhe udhëheq dokumentacionin e Lëvizjes BESA;
- Kujdeset për zbatimin e vendimeve të Kryetarit, Këshillit Qendror, Kryesisë Qendrore dhe Sekretariateve;
- Përgatit dhe kujdeset për mbarëvajtjen e takimeve të organeve të Lëvizjes BESA si dhe ndihmon kryetarët e organeve të Lëvizjes në thirrjen e mbledhjeve dhe organizimin e punës;
- Mban kontakte të rregullta me Komisionin Qendror Zgjedhor;
- Kryen edhe punë tjera të cilat i besohen nga Kryesia Qendrore respektivisht Kryetari i Lëvizjes.

## **14. FINANCIMI**

### **Neni 54**

Burimet financiare të Lëvizjes BESA përbëhen nga kuotizacionet e anëtarësisë, nga grantet që jep buxheti i shtetit sipas ligjit, nga ndihma e dhurata publike që njeh ligji për partitë politike si dhe nga çdo burim tjetër konform ligjit për financim të partive politike.

Të gjitha burimet dhe mënyra e financimit në përgjithësi e Lëvizjes BESA është publike dhe transparente.

Raporti përfundimtar për financimin e Lëvizjes BESA miratohet nga Këshilli Qendror.

Kompetent për të kontrolluar financat e Lëvizjes BESA është Sekretari Gjeneral në përputhje me këtë Statut.

Grumbullimi dhe administrimi i kuotave e kontributeve bëhet konform Rregullores së brendshme, që e miraton Këshilli Qendror i Lëvizjes BESA.

#### **Neni 55**

Lëvizjes BESA financohet nga;

- Anëtarësia e Lëvizjes BESA;
- Buxheti i RM-së sipas rregullave ligjore që vlejné për të gjitha subjektet politike;
- Donacionet nga donatorë të ndryshëm;
- Grantet e ndryshme;
- Sponzorimet e ndryshme;
- Dhuratat;
- Mënyra tjera fitimprurëse sipas dispozitave ligjore që vlejné për financimin e partive politike.

### **15. FORUMI I GRUAS DHE FORUMI RINOR**

#### **Neni 56**

Në kuadër të organeve të Lëvizjes BESA, funksionojné edhe Forumi i Gruas dhe Forumi Rinor të cilat kanë për qëllim të promovojné idetë, vlerat dhe vizionin e BESA në grupet shoqërore në të cilat veprojnë.

Për realizimin e interesave të tyre politike, arsimore, kulturore, sportive dhe profesionale në kuadër të Lëvizjes organizohen në organizata të tyre me emrin Forumi i Gruas dhe Forumi Rinor i Lëvizjes BESA.

Kryetar i FG-së dhe FR-së zgjedhet nga rrathët e anëtarëve të Lëvizjes, me mandat 4 (katër) vjeçar dhe me të drejtë rizgjedhjeje vetëm edhe për një mandat.

Mënyra e zgjedhjes dhe organizimit të brendshëm të FG-së dhe FR-së të Lëvizjes BESA rregullohet me Rregullore të veçantë për secilin forum, të cilat miratohen nga Këshilli Qendror i Lëvizjes BESA.

### **16. GRUPI PARLAMENTAR DHE PËRFAQËSUESIT E ZGJEDHUR**

#### **Neni 57**

Përfaqësuesit e zgjedhur nga populli (deputetët) të Lëvizjes BESA në Parlamentin e Maqedonisë organizohen në Grup Parlamentar.

Grupi parlamentar përfaqëson në Parlament Lëvizjen BESA dhe politikat e Lëvizjes BESA.

Grupi parlamentar me konsultim paraprak me Kryesinë Qendrore emëron koordinatoren e Grupit.

Në Parlament Grupi Parlamentar mbron platformën, programin dhe interesat e Lëvizjes BESA.



Grupi Parlamentar në Parlament punon në bazë të dispozitave Statutare të Lëvizjes BESA, konsultohet me Kryesinë dhe Kryetarin e Lëvizjes për çështje të caktuara. Ky Grup vendos për ndarjen e anëtarëve të tij në komisionet e ndryshme parlamentare.

Në nivel lokal respektivisht komunal, këshilltarët nga radhët e Lëvizjes BESA organizohen si grup i këshilltarëve. Grupi i këshilltarëve komunal, merr qëndrime politike dhe vendimmarrje në bazë të konsultimit të Kryesisë së Këshillit Komunal të Lëvizjes BESA.

Për mënyrën më të hollësishme të funksionimit dhe organizimit Grupi Parlamentar përpilon rregulloren e saj.

## **17. ORGANET TJERA – SEKRETARIATET**

### **Neni 58**

Organet tjera të Lëvizjes BESA janë:

- Sekretariati i Departamenteve.
- Sekretariati i Politikave Strategjike;
- Sekretariati i burimeve njerëzore dhe lobimit;
- Sekretariati organizativ;
- Sekretariati për marrëdhënie me publikun.

Të gjitha sekretariatet në organizimin e brendshëm do të kenë departamente për çështje të caktuara, të cilat do të përshkruhen me Rregullore të veçantë.

### **17.1. Sekretariati i Departamenteve**

#### **Neni 59**

Ky sekretariat në përbërje të tij funksionon sipas mënyrës organizative të ministrive të ndryshme në Maqedoni.

Ky Sekretariat monitoron punën e Qeverisë dhe organeve tjera shtetërore sipas sektorëve përkatës dhe jep informata zyrtare, bën përgatitjen e materialeve dhe propozon politikat e Lëvizjes në raport me këta organe.

Ky sekretariat përbëhet specialistë dhe ekspertë të fushave të ndryshme, të cilët veprojnë brenda këtij sekretariati sipas profesioneve të caktuara.

Sekretariati i departamenteve në organizimin e tij të brendshëm ka disa departamente, si:

- Departamenti i punëve të brendshme;
- Departamenti i punëve të jashtme;
- Departamenti i ekonomisë;
- Departamenti i drejtësisë;
- Departamenti i punës dhe politikës sociale;
- Departamenti i ekologjisë;
- Departamenti i shëndetit;
- Departamenti i transportit dhe lidhjeve;
- Departamenti i mjedisit dhe planifikimit hapësinor;
- Departamenti i bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave,
- Departamenti i kulturës qytetare;

- Departamenti i mbrojtjes;
- Departamenti i arsimit dhe shkencës;
- Departamenti i shoqërisë informatike dhe administratës shtetërore;
- Departamenti i Qeverisjes lokale.

Ky Sekretariat mund të themelojë edhe departamente tjera sipas nevojës.

Të gjitha departamentet nga rrathët e tyre zgjedhin Drejtor, i cili do të udhëheqë me punën e departamentit.

Drejtorët e Departamenteve përbëjnë Sekretariatit e departamenteve. Drejtorët e Departamenteve nga radhët e tyre zgjedhin Sekretar të Sekretariatit e departamenteve, me mandat 4 (katër) vjeçar, i cili do ta përfaqësojë sekretariatit në të gjitha organet e Lëvizjes.

Për veprimtarinë, mënyrën organizative si dhe të drejtat dhe detyrimet e Sekretariatit të departamenteve, Këshilli Qendror do të sjell Rregullore të veçantë.

## 17.2. Sekretariati i politikave strategjike

### Neni 60

Ky Sekretariat harton strategjinë e ardhjes në pushtet të Lëvizjes BESA, si dhe politikat afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjata të Lëvizjes BESA.

Monitoron punën e organizimit strategjik dhe strategjinë e zgjedhjeve elektorale të Lëvizjes BESA.

Ky sekretariat përbëhet specialistë dhe ekspertë të fushave të ndryshme, të cilët veprojnë brenda këtij sekretariati sipas profesioneve të caktuara.

Përcakton strategjinë e partneritetit dhe bashkëpunimin me organizata simotra, rrugët dhe mjetet të cilat i ndjek Lëvizja BESA.

Përgatit plane vjetore të cilat bëhen të detyrueshme për të gjithë Sekretariatet e Lëvizjes dhe strukturat tjera për të cilat vendos edhe Këshilli Qendror i Lëvizjes BESA.

Përgatit materiale politike për përdorim të brendshëm dhe atë publik të Lëvizjes.

Sekretariati i politikave Strategjike përpilon strategjinë elektorale të Lëvizjes BESA.

Ky sekretariat është përgjegjës edhe për çështjet programore dhe dispozitat Statutare të Lëvizjes BESA.

Ky sekretariat nga radhët e tyre zgjedh Sekretar të Sekretariatit të politikave strategjike, me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Sekretari i Sekretariatit të politikave strategjike përfaqëson Sekretariatit në të gjitha organet e Lëvizjes.

Për veprimtarinë, mënyrën organizative si dhe të drejtat dhe detyrimet e Sekretariatit të politikave strategjike, Këshilli Qendror do të sjell Rregullore të veçantë.

### **17.3. Sekretariati i burimeve njerëzore dhe lobimit**

#### **Neni 61**

Ky Sekretariat është filtri nga i cili kalon një pjesë e anëtarësimit në Lëvizjes BESA dhe informacionit për burimet njerëzore duke u bazuar në individët kapacitativ, me influencë dhe me rëndësi në shoqëri.

Ky Sekretariat ka për qëllim udhëheqjen e politikës kadrovike brenda Lëvizjes BESA.

Nga radhët e veta zgjedh Sekretar, me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Sekretari i Sekretariatit burimeve njerëzore dhe lobimit përfaqëson sekretariatit në të gjitha organet e Lëvizjes.

Kjo kategori e anëtarësimit nuk kalon përmes strukturave lokale organizative të BESA por ata anëtarësohen drejtpërdrejt në këtë Sekretariat. Këta persona propozohen nga informacionet e burimeve njerëzore në përbërje të Sekretariatit.

Për veprimtarinë, mënyrën organizative si dhe të drejtat dhe detyrimet e Sekretariatit, Këshilli Qendror do të sjell Rregullore të veçantë.

### **17.4. Sekretariati organizativ**

#### **Neni 62**

Sekretari organizativ në koordinim me Sekretarin Gjeneral merret me organizimin e Lëvizjes BESA, në nivel qendror dhe lokal, në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e Lëvizjes BESA.

Sekretariati organizativ nga radhët e veta zgjedh sekretar me mandat prej 4 (katër) vjetëve, me të drejtë rizgjedhjeje.

Sekretari organizativ për punën e vet përpilon Rregullore të cilën e propozon për miratim deri te Këshilli Qendror.

### **17.5. Sekretariati i marrëdhënieve me publikun**

#### **Neni 63**

Sekretariati i marrëdhënieve me publikun përcakton imazhin dhe pamjen e Lëvizjes BESA në shfaqjen publike.

Propozon plane të karakterit mediatik dhe vendos për qasjen e marketingut të Lëvizjes në elektorat dhe gjatë kampanjës zgjedhore.

Ky sekretariat nga radhët e veta zgjedh sekretar, me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Sekretari i sekretariatit të marrëdhënieve me publikun njëherit është edhe Zëdhënës i Lëvizjes BESA.

Sekretariati në konsultim me Kryetarin e Lëvizjes, vendos për kontaktet me mediet e shkruara dhe elektronike.

Vendos për bashkëpunimin me institucionet e ndryshme mediatike dhe me to komunikon në bazë të konsultimit dhe autorizimit paraprak nga Kryesia Qendrore respektivisht Kryetari.

Ky sekretariat kujdeset dhe realizon prezantimin elektronik të Lëvizjes BESA.

## **18.**

### **QENDRA HULUMTUESE-ANALITIKE**

#### **Neni 64**

Me qëllim ndërtimin e një platforme politike si dhe ngritjes së debateve kualifikuese dhe strukturale, Këshilli Qendror i Lëvizjes BESA themelon Qendrën hulumtuese-analitike.

Qendra hulumtuese formohet si organizim i brendshëm i Lëvizjes BESA, e cila nuk ka cilësinë e personit juridik.

Puna e Qendrës hulumtuese-analitike është e ndarë në dy pjesë:

- Pjesa operative, e cila është pjesë e hulumtimeve të përditshme të Lëvizjes, përpunimin e të dhënave të nevojshme për Lëvizjen, planifikon aktivitetet e ardhshme, si dhe bën veprimtari tjera që lidhen me funksionimin dhe politikën përkatëse të Lëvizjes duke përfshirë edhe kostot e shpenzimeve të mirëmbajtjes së Qendrës analitike-hulumtuese, dhe
- Pjesa projektuese, e cila shoqërohet me organizimin e aktiviteteve që përfshijnë organizimin publik të debateve, seminareve, punëtorive, anketat e opinionit publik, publikimin e studimeve dhe hulumtimeve, vlerësimin e politikave, monitorimin e zhvillimeve dhe proceseve shoqërore në Republikën e Maqedonisë, relacionet ndër-partiake dhe aktivitetet ndërkombëtare si dhe aktivitete të tjera në fushën e hulumtimeve dhe aktiviteteve analitike.

Për organizimin e brendshëm të Qendrës hulumtuese-analitike, Këshilli Qendror do të sjell Rregullore të veçantë.

## **19. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 65**

Çdo rregullore, vendim, rekomandim apo akte tjera të nxjerra nga organet e Lëvizjes BESA, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me këtë Statut.

#### **Neni 66**

Në afat prej 6 (gjashtë) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Statuti, organet kompetente përpilojnë rregullore për mënyrën e punës së tyre dhe i dorëzojnë Këshillit Qendror për miratim.

#### **Neni 67**

Çështjet të cilat nuk janë të parapara dhe rregulluara me këtë Statut, Këshilli Qendror do ti rregulloj me anë të vendimeve dhe akteve të posaçme.

### **Neni 68**

Ky Statut hynë në fuqi ditën e miratimit të Këshillit Iniciativë të Lëvizjes BESA, dhe vlen deri në miratimin e plotfuqishëm të këtij Statuti nga Kongresi.

Shkup,  
27.12.2014

Lëvizja BESA